



SHËRBIMI I PROVËS

Nr. 239, datë 02/02/2024



Nr. 7, datë 2/2/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, përfaqësuar nga Z. Klevis QOSE, Drejtor i Përgjithshëm, në bazë të tagrave që i jep Ligji Nr. 8331 datë 21.04.1998 “Per ekzekutimin e Vendimeve Penale”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8331, dte 27.11.2008, si dhe Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.302, date 25.03.2009 “Per miratimin e Rregullores për Organizimin e Funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për “Përcaktimin e Standarteve dhe Procedurave për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të Denimeve Alternative”, si Palë e Parë;

Dhe

Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, (DHKN), përfaqësuar nga Znj. Drita AVDYLI, PhD, Kryetar, në bazë të tagrave që i jep Ligji nr.10385, dte 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 26/2018 datë 17.05.2018, si Palë e Dytë:

PALËT deklarojnë që me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Palëve dhe realizimi i procesit të ndërmjetësimit midis të dënuarëve me masa alternative dhe viktimave apo familjarëve të tyre.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit, drejtësisë restauruese dhe organizimi i veprimtarive të përbashkëta të natyrës promovuese, ndërgjegjësuere, dhe trajnuese në fushën e drejtësisë restauruese dhe të shërbimit të ndërmjetësimit.

Gjithashtu fusha e bashkëpunimit do të zgjerohet në trajnime, workshope të përbashkëta, në projekte rajonale, IPA apo të ndryshme, në konferenca kombëtare e ndërkombetare si dhe fusha të ndryshme, në interes të dy Paleve.

Neni 3

Baza Ligjore

Baza ligjore e kësaj Marrëveshje janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; neni 6 pika 3, neni 9 gërma g, neni 40 pika 2, neni 43 pika 1; neni 28 i VKM-së nr. 302 datë 25.03.2009 “Për miratimin e Rregullores Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standarteve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”; Ligji nr. 8788, datë 31.07.2009 “Për miratimin e Rregullores për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-te dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit”.

Neni 4

Detyrimet e DHKN-se

1. *Ne marrëdhënien e bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN), përmbush detyrimet e mëposhtme:*
 - a. Depoziton pranë SHP, listën e ndërmjetësve me gjeneralitetet dhe kontaktet e tyre;
 - b. Siguron që të gjithë ndërmjetësit që ofrojnë shërbimin e tyre në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit janë të trajnuar në çështje të ndërmjetësimit midis të dëmtuarit dhe të dënuarit dhe të drejtësisë restauruese;
 - c. Kryen veprimet e nevojshme për të kontaktuar dhe, kur është e nevojshme, për të takuar, veçmas të dëmtuarin dhe të dënuarin, me qëllim përgatitjen e tyre paraprake për seancat e ndërmjetësimit;
 - d. Ofron shërbimin e ndërmjetësimit pa pagesë për të miturit në konflikt me ligjin dhe për shtresat vulnerabël nën mbikëqyrjen e SHP.
 - e. Informon Degën Territoriale të Shërbimit të Provës mbi përputhshmërinë e cdo rasti me programet e ndërmjetësimit;
 - f. Siguron që cdo program ndërmjetësimi të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme dhe të ndiqet nga ndërmjetës të aftë për të përgatitur dhe siguruar një takim të qetë dhe të sigurt të të dëmtuarit dhe të dënuarit.
 - g. Përfshin në programet e ndërmjetësimit edhe prindërit e të dënuarit, kur ky i fundit është i mitur;
 - h. Kur është e përshtatshme, përfshin në programet e ndërmjetësimit anëtarë të komunitetit, familjare, juriste apo dhe punonjës të SHP me qëllim arritjen e rezultateve në përmirësimin e marrëdhënies midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, riparimin e dëmit të shkaktuar dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale;
 - i. Informon SHP mbi ecurinë e procesit të ndërmjetësimit në mënyrë periodike;
 - j. Zhvillon ndërmjetësimin në mënyrë më të përshtatshme për të dëmtuarin dhe të dënuarin mbështetur në rrethanat e kryerjes së veprave penale, pasojat e saj dhe sjelljen ndërmjet tyre;

- k. Informon SHP kur cmon se për arsye objektive apo subjektive procesi i ndërmjetësimit nuk mund të kryhet duke përshkruar dhe shkakun;
 - l. I pergjigjet me shkrim cdo kërkesë të SHP për informacion mbi një rast të caktuar bashkëpunimi;
 - m. Siguron që programet e ndërmjetësimit i përshtaten dhe mbajnë parasysht nevojat dhe shqetësimet e të dëmtuarit.
2. Në përfundim të procesit të ndërmjetësimit, DHKN-ja:

- a. I paraqet Shërbimit të Provës një raport rreth zhvillimeve të programit dhe rezultateve të arritura. Në raport përfshihet informacion mbi arritjen ose jo të një marrëveshje dhe mbi mundësinë e kërkesës së përfundimit të procedimit penal sipas ligjit;
- b. I paraqet kopje të raportit të ndërmjetësimit të dëmtuarit, të dënuarit dhe Shërbimit të Provës;
- c. Kur është arritur një marrëveshje midis të dënuarit dhe të dëmtuarit, ndjek në vijimësi përmbushjen e marrëveshjes midis të dënuarit dhe të dëmtuarit, ndjek në vijimësi përmbushjen ose jo të detyrimeve të marra përsipër nga i dënuari;
- d. Shërbimi i Ndërmjetësimit, në veprimtarinë e tij, respekton kërkesat e ligjit nr. 9877, datë 10.03.2009 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 5

Detyrimet e Shërbimit të Provës

1. Në marrëdhënien e bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN), Shërbimi i Provës, përmbush detyrimet e mëposhtme;
- a. Vlerëson nëse rasti është i përshtatshëm për ndërmjetësim midis të dëmtuarit dhe të dënuarit;
 - b. Harton një Letër Reference për të dënuarin dhe komunikon me DHKN për të siguruar një ndërmjetës të pavarur dhe të paanshëm për zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit;
 - c. I dërgon DHKN Letër Referencën jo më vonë se 3 ditë pas vlerësimit të nevojës për ndërmjetësim;
 - d. Informon të dënuarin mbi mundësinë që ka për të ofruar këshillimin dhe mbështetjen për tu ndërmjetësuar me të dëmtuarin;
 - e. Komunikon me personin përgjegjës të caktuar nga DHKN për të rënë dakord mbi datën dhe orën, në të cilën i dënuari i shoqëruar nga punonjësi i shërbimit do të paraqitet pranë institucionit;
 - f. Përfshin raportin e vlerësimit të përgatitur për prokurorinë apo gjykatën mbi bashkëpunimin me DHKN dhe rezultatet e tij;
 - g. Përfshihet aktivisht në zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive të Shërbimit të Ndërmjetësimit që realizohen në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, me qëllim sigurimin që DHKN i përmbush detyrimet e tij dhe shërbimi që i ofrohet të dënuarit është cilësuar dhe eficient;
 - h. Kur si rrjedhojë e ndërmjetësimit, verifikohen rrethanat e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose të ndihmës aktive për zhdukjen ose pakësimin e pasojave dhe të normalizimit të marrëdhënieve, SHP i përshkruan këto rrethana në raportin e vlerësimit;

- i. Në rastin e të dënuarëve, vecanërisht të atyre që kërkojnë lirim me kusht, SHP identifikon të dëmtuarin dhe shqetësimet e tij të mundshme që lidhen me kthimin e të dënuarit në komunitet dhe parashikon në raportin e vlerësimit dhe në planin individual të trajtimit bashkëpunimin me DHKN me qëllim normalizimin e marrëdhënieve midis të dënuarit dhe të dëmtuarit;
- j. Implementojnë projekte dhe konferenca shkencore të përbashkëta.

Neni 6

Konfidencialiteti

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje do të respektojnë konfidencialitetin e të dhënave që lidhen me palët e përfshira në procesin e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruse në respektim të ligjeve në fuqi.

Neni 7

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë kësaj periudhe.

Neni 8

Personat e kontaktit

Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje personat e kontaktit janë si në Aneksin 1.

Personat e caktuar në Aneksin 1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces - verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në Aneksin 1, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese të dhënat e personit të ri të kontaktit brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të cilat njëkohësisht do t'i bashkëlidhen Marrëveshjes nëpërmjet anekseve.

Neni 9

Zbatimi i Marrëveshjes

Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga data e nënshkrimit dhe do të përpiqen ti zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të rrjedhin jashtë zbatimit të saj.

Për cdo problem gjatë zbatimit të marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes.

Cdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa do lidhen me këtë akt-marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

Neni 10

Dispozita të fundit

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Për

DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË

SHËRBIMIT TË PROVËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis QOSE



Për

DHOMËN KOMBËTARE TË

NDËRMJETËSIMIT

KRYETAR

Drita AVDYLI

